Perëndimi përballë agresionit rus dhe impakti në vendet e Ballkanit Perëndimor

Bota po përballet sot me një dinamikë të paparë më parë, duke u orientuar drejt një "Lufte të re të Ftohtë", ose madje drejt një "Luftë të Tretë Botërore", e cila në realitet ka filluar tashmë. Pas agresionit të Federatës Ruse kundër Ukrainës, shtetet evropiane kanë kuptuar domosdoshmërinë e përgatitjes për një rrezik të mundshëm, por jashtëzakonisht real të sigurisë.

Ndërkohë, Republika e Shqipërisë, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi vazhdojnë të mbeten në një gjendje pasiviteti strategjik. Historia po përsëritet në Ballkan. Edhe në vitet 1870 dhe më pas, Serbia dhe disa satelitë të Rusisë u përgatitën me ritme të shpejta për luftë. Pasuan konfliktet e viteve 1878, 1911–1913 dhe 1914–1918, ku popujt që "flinin" pësuan më së shumti, ndërsa ata që u përgatitën zgjeruan territoret e tyre në mënyrë të shumëfishtë.

Strategjitë e Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara tregojnë qartë rreziqet që i kanosen SHBA-së (dhe Perëndimit në tërësi, përfshirë Shqipërinë, Kosovën etj.) nga ajo që shumë analistë e quajnë "Terror-Rusia", si dhe nga Kina në të ardhmen e afërt, së bashku me satelitët e tyre lokalë — kryesisht Serbinë dhe disa pseudo-aleatë të NATO-s, si Turqia dhe Greqia. Asnjë strategji, studiues apo ekspert i sigurisë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut apo Malin e Zi nuk e thekson faktin se Serbia, përmes aleancave me Kinën, Rusinë, Turqinë dhe disa vende arabe, po ndjek plane ekspansioniste afatgjata drejt Bosnjë e Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.

Agresioni rus ka detyruar qeveritë evropiane të rrisin buxhetet e mbrojtjes në nivele të papara që nga periudha e Luftës së Ftohtë. Kërkesa për municion, sisteme ajrore pa pilot, platforma raketore, mjete të blinduara dhe avionë luftarakë është rritur ndjeshëm. NATO ka vendosur objektiva të reja kapacitetesh, përfshirë angazhimin për të arritur deri në 5% të PBB-së për mbrojtjen deri në vitin 2035, duke nxitur investime të mëtejshme. Doktrinat ushtarake janë në tranzicion, duke kaluar nga sistemet me ekuipazh tek ato pa ekuipazh. Doktrina e ndjekur nga Ukraina dhe Rusia synon ekonomizimin e luftës — zhvillimin e saj me kosto sa më të ulët, çka përputhet plotësisht me luftën me dronë dhe UGV.

Ukraina rriti shpenzimet ushtarake me rreth 640% në vitin 2022, duke arritur 44 miliardë USD, dhe 64.7 miliardë USD në vitin 2024. Rusia e rriti buxhetin e saj të mbrojtjes në 149 miliardë USD në vitin 2024 (+38%), rreth 7.1% të PBB-së. Shitjet globale të industrisë së armëve arritën 679 miliardë USD në vitin 2024, një rekord historik i lidhur drejtpërdrejt me luftën në Ukrainë dhe konfliktet e tjera. Shpenzimet ushtarake globale u rritën nga 2.24 trilion USD në 2022 në 2.718 trilion USD në 2024 (+9.4%). Evropa regjistroi rritjen më të shpejtë: në vitin 2025, shpenzimet evropiane të mbrojtjes arritën 563 miliardë USD, rreth 100 miliardë më shumë se një vit më parë (+12.6%).

Prodhimi global i dronëve (OEM) pritet të rritet nga 596,940 njësi në 2025 në 869,760 njësi në 2030 (+45.7%). Vlera e tregut të UAV-ve rritet nga 26.12 miliardë USD (2025) në 40.56 miliardë USD (2030), një rritje prej +55%. Tregu i UAV-ve ushtarakë, i vlerësuar në 18.2 miliardë USD në vitin 2025, pritet të arrijë 39.4 miliardë USD në 2031 dhe 66.5 miliardë USD në 2035 (+265% në dhjetë vjet). Burime të tjera japin vlerësime alternative, por të gjitha tregojnë rritje të fortë strukturore.

Investimet në UGV (Unmanned Ground Vehicles) janë gjithashtu në rritje. Në buxhetin amerikan FY2026 janë parashikuar 13.4 miliardë USD për sisteme autonome: – 9.4 miliardë USD për UAV dhe sisteme të telekomanduara – 3.1 miliardë USD për kundër- UAS Programi Replicator përfshin kërkesa prej 300 milionë USD (2023), 200 milionë USD (2024) dhe 500 milionë USD (2025).

Investimet e ardhshme:– SHBA po zhvendos 50 miliardë USD nga programet e vjetra drejt dronëve dhe sistemeve kundër dronëve. – Franca ka ndarë 500 milionë euro për dronë në buxhetin e vitit 2024; startup- et evropiane po marrin financime të konsiderueshme. – Ukraina planifikon të blejë 4.5 milionë dronë FPV në vitin 2025, me një buxhet prej 2.6 miliardë USD, duke sinjalizuar rritje të jashtëzakonshme të prodhimit vendor.

Përmbledhje

- Prodhimi global i dronëve rritet me +45.7% deri në 2030
- Tregu i dronëve ushtarakë rritet me +265% deri në 2035
- Investimet globale në autonomi arrijnë dhjetëra miliarda USD në vit
- Evropa po rrit ndjeshëm investimet në mbrojtje
- Ukraina po shndërrohet në një nga prodhuesit më të mëdhenj të dronëve FPV në botë

Rekomandime

1. SHBA, NATO dhe BE duhet të kërkojnë nga çdo shtet anëtar i NATO- s rritjen e kapaciteteve ushtarake, profesionalizimin e forcave dhe koordinimin e tyre në kuadër të Mbrojtjes Kolektive. Polonia, Norvegjia, Suedia, Ukraina, Gjermania dhe Japonia kanë rritur ndjeshëm buxhetet e tyre ushtarake.
2. SHBA duhet të zbatojë mekanizma verifikimi brenda strukturave vendimmarrëse të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi për të identifikuar agjentët rusë, serbë, turq dhe aktorë të tjerë të huaj që kryejnë veprimtari subversive dhe pengojnë përafrimin me standardet e NATO- s.

Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina janë bërë shpesh objektiv i agresioneve të hapura ose të fshehta nga ajo që disa analistë e quajnë "Terror- Rusia e vogël e Ballkanit" (Serbia). Ringjallja e ekstremizmit islamik u pa së fundmi në rastin e "Zvërnecit" në Shqipëri. Agjentë nga Serbia, Greqia dhe Turqia ndërhynë nën pretekstin e "mbrojtjes" së Shqipërisë. Përgjegjësia nuk qëndron tek këta agjentë, por tek institucionet e Republikës së Shqipërisë, të cilat kanë dështuar të parandalojnë, luftojnë dhe neutralizojnë ideologjitë radikale, ekstremiste dhe terroriste.

Shkruar nga Skender Jashari

Phd candidate, Criminologist, Counter-Terrorism Expert, Hybrid Warfare Specialist | Scientific Researcher | Security Policy Advisor, Aerospace & Ground Systems Designer specializing in Drones (VTOL, Fixed-Wing), UUVs, ROVs, UGV, and USVs.